



Komuna Obiliq  
Opština Obilić - Municipality Obiliq

**ZYRA E KRYETARIT**  
**Kabinet Presednika – Office of the Mayor**

**NJOFTIM**

Njoftohen të gjithë qytetarët, institucionet dhe operatorët ekonomikë se është përcaktuar organizimi dhe ofrimi i shërbimit të mbledhjes dhe transportimit të mbeturinave komunale në territorin e Komunës së Obiliqit.

Sipas këtij njoftimi:

- Shërbimi i mbledhjes dhe transportimit të mbeturinave komunale në territorin e Komunës së Obiliqit do të organizohet dhe ofrohet nga NPL “Kastrioti” Sh.A , në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet komunale përkatëse.
- Të gjithë operatorët ekonomikë, publikë ose privatë, që ushtrojnë veprimtari në fushën e mbledhjes dhe transportimit të mbeturinave komunale janë të obliguar që veprimtarinë e tyre ta zhvillojnë vetëm në përputhje me autorizimet, lejet ose kontratat e lëshuara nga Komuna e Obiliqit dhe legjislacioni në fuqi.
- Asnjë operator ekonomik nuk mund të kryejë shërbimin e mbledhjes dhe transportimit të mbeturinave komunale pa autorizim ose pa marrëdhënie juridike të rregulluar me Komunën e Obiliqit.
- Drejtoritë komunale, Inspektorati Komunal dhe organet tjera kompetente do të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij njoftimi dhe mbikëqyrjen e ofrimit të shërbimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky njoftim publikohet me qëllim të informimit të qytetarëve dhe operatorëve ekonomikë për zbatimin e njoftimi dhe respektimin e dispozitave ligjore që rregullojnë menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Obiliqit.

T’i dorëzohet:

- Zyrës së Kryetarit
- Drejtorive
- NPL “Kastrioti” Sh.A
- arkivit

Kryetari i Komunës

Adil Thaçi

